

DUHANI NDIKON TE TI

Duhani rrit rrezikun e shfaqjes së rreth 50 sëmundjeve

Duhani shkakton rreth 90% të kancerit të mushkërive. Duhani mund të jetë shkaktari i kancerit në shumë pjesë të tjera të trupit si:

- në gojë
- buzë
- fyt
- laring
- ezofag
- fshikëzës
- veshkave
- mëlcisë
- stomakut
- pankreasit

Pirja e duhanit dëmton zemrën dhe qarkullimin e gjakut, duke rritur rrezikun e zhvillimit të sëmundjeve të tilla si:

- sëmundjet koronare të zemrës
- infarkt në zemër
- sëmundjet vaskulare periferike (dëmtimi i enëve të gjakut)
- sëmundjet cerebrovaskulare (dëmtimi i arterieve që furnizojnë trurin me gjak)

Si ndikon pirja e duhanit në zemër dhe gjak?

Kimikatet e tymit të duhanit dëmtojnë qelizat e gjakut dhe funksionimin e zemrës. Ky dëmtim rrit rrezikun për:

- atherosclerosis, (sëmundje në të cilën një substancë e lëmuar e quajtur pllakë ngrihet deri në arterie)
- aneurysms, (fryrja e enëve të gjakut e cila çon deri në vdekje)
- sëmundje kardiovaskulare (CVD), e cila përfshin:
- sëmundje koronare të zemrës (CHD),
- atakun e zemrës dhe dëmtimin e arterieve, dhimbje gjoksi
- presionin e lartë të gjakut
- sëmundjet koronare të zemrës, ku piastrina, përbërës i gjakut, bashkohet me proteinat dhe mund t'i ngjiten pllakave të mureve të arterieve duke shkaktuar infarkt në zemër
- sëmundjet periferike arterial (PAD),
- goditja, e cila është vdekje e papritur e qelizave të trurit shkaktuar nga mpiksja e gjakut ose gjakderdhja

Si ndikon pirja e duhanit në mushkëri dhe në frymëmarrje?

Çdo cigare dëmton frymëmarrjen dhe mushkëritë. Pirja e duhanit shkakton:

- Sëmundje kronike obstruktive të mushkërive (COPD), një sëmundje që përkeqësohet me kalimin e kohës dhe shkakton gulçim, ngushtim gjoksi, dhe simptoma të tjera
- Emfizemë, një gjendje në të cilën muret në mushkëri humbasin aftësinë e tyre për tu shtrirë dhe për tu tkurrur. Indet e mushkërive shkatërrohen, duke e bërë të vështirë ose të pamundur frymëmarrjen.
- Bronkit kronik, i cili shkakton ënjtje të tubave bronkiale. Kur ndodh kjo, sasia e ajrit që hyn në mushkëri është më e vogël.
- Pneumoni
- Azëm
- Tuberkuloz

A ndikon pirja e duhanit në shikim?

Pirja e duhanit është e dëmshme për sytë ashtu si edhe për çdo pjesë tjetër të trupit. Kërkime të ndryshme e lidhin pirjen e duhanit me rritjen e rreziqeve për dëmtimin e nervave optike i cili çon deri në verbim.

Pirja e duhanit gjatë shtatzanisë

Pirja e duhanit gjatë shtatzanisë, rrezikon shëndetin e fëmijës të palindur, si edhe të nënës. Pirja e duhanit gjatë shtatzanisë rrit rrezikun e komplikimeve të tilla si:

- abort
- lindjes së parakohshme
- lindje e një fëmije me peshë të vogël
- lindje e një fëmije të vdekur

Rreziqet e pirjes së duhanit pasiv

Njerëzit që konsiderohen si duhanpirës pasiv kanë të njëjtat pasoja si ata aktiv, veçanërisht kur i referohemi kancerit të mushkërive dhe sëmundjeve të zemrës. Për shembull, duhanpirja pasive rrit rrezikun e kancerit të mushkërive apo sëmundjeve të zemrës me rreth 25%. Foshnjat dhe fëmijët janë veçanërisht të ndjeshme ndaj efekteve të duhanit pasiv. Një fëmijë i cili është i ekspozuar ndaj duhanit pasiv rrezikon rritjen e mundësisë së zhvillimit të infeksioneve të rrugëve të frymëmarrjes, të kollës kronike dhe, në qoftë se ata kanë astmë, përkeqësimit të simptomave të tyre.